



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-0/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-1365/14</u>
Nr. I faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>17.04.2014</u>
PRISHTINË	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 17.04.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. nr. AKK – 03-517/14, për z. Sabri Hamiti – Deputet i Kuvendit të Kosovës dhe Anëtar i Këshillit Shtetëror për Cilësi, për shkak se z. Hamiti ka dhënë dorëheqje nga funksioni i Anëtarit të Këshillit Shtetëror për Cilësi, me çka ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik nr. AKK – 03-517/14, për z. Sabri Hamiti – Deputet i Kuvendit të Kosovës, dhe njëkohësisht anëtar i Këshillit Shtetëror për Cilësi (si organ qeverisës i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës), është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, z. Hamiti, fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është takuar me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet t'i bëj për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Në këtë takim z. Hamiti ka deklaruar se funksioni të cilin e mban në Këshillin Shtetëror për Cilësi është vetëm këshillues, duke shtuar se për lejimin e ushtrimit të këtij funksioni është konsultuar me Zyrën Ligjore të Kuvendit të Kosovës, nga e cila ka marrë konfirmimin me shkrim se ushtrimi i funksionit si anëtar i Këshillit Shtetëror për Cilësi, krahas funksionit të deputetit, nuk paraqet konflikt interesi.

Mirëpo, Agjencia, si institucion i pavarur, që ndër të tjera bën mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit, pas shqyrtimit të provave në dispozicion ka konstatuar se ushtrimi i këtyre dy funksioneve në të njëjtën kohë, paraqet papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik sepse bie ndesh me nenin 72 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në këtë nen shprehimisht thuhet: *“Deputeti i Kuvendit të Kosovës nuk mund të mbajë ndonjë post ekzekutiv në administratën publike ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi publike, dhe as të ushtrojë ndonjë funksion tjetër ekzekutiv, sikurse është përcaktuar me ligj”*.

Meqenëse të gjithë anëtarët e Këshilit në fjalë emërohen nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, funksioni i anëtarit në Këshillin Shtetëror për Cilësi është funksion i kontrolluar nga Qeveria, dhe bazuar në këtë dispozitë kjo mund të ndikoj në masë të konsiderueshme në pavarësinë e deputetit.

Ushtrimi i njëkohshëm i këtyre funksioneve përbën po ashtu konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik pasi që, Këshilli Shtetëror për Cilësi i raporton çdo vit Kuvendit dhe Ministrisë (Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, neni 7, pika 4).

Rrjedhimisht, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit parasheh parimet e veprimt dhe mos veprimt të zyrtarit. Në nenin 7 (paragrafi 8) të këtij ligji parashihet se, zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm.

Andaj, duke pasur parasysh këto dispozita, Agjencia i ka dërguar z. Hamiti shkresën e dytë (shkresën paralajmëruese për konstatimin e konfliktit të interesit), përmes së cilës është kërkuar nga ai që t'i ndërmarr të gjitha hapat për shmangien e gjendjes së konfliktit të interesit brenda afatit 15 ditë nga pranimi i këtij njoftimi, në të kundërtën Agjencia është e obliguar të veproj konform nenit 18 paragrafi 10 të Ligjit Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ndërkohë, z. Hamiti, ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (Nr. Prot. 03-1352/14), në të cilën vërtetohet se i njëjti ka dhënë dorëheqje nga të qenurit anëtar i Këshillit Shtetëror për Cilësi.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatojmë se është tejkaluar papajtueshmëria në ushtrimin e funksionit publik dhe është shmangur gjendja e konfliktit të interesit.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

